

INKLUZIONI
CENTER FOR SOCIAL INCLUSION AND INNOVATION

UDHËZUES PRAKTIK

USHTRIME LOGOPEDIKE

Aktivitete praktike për punë me fëmijët në kushte shtëpie

INKLUZIONI • 2026

GJILAN, KOSOVË

AUTORËT • MBËSHTETJA

Të dhënat botuese dhe institucionale

AUTORËT

Altinë Mehmeti

Artiola Ilijazi

Argjent Abazi

Nora Rrahmani

Urtina Misini

Ekipi profesional i logopedëve

Ky manual dhe të gjitha aktivitetet logopedike të përfshira në të janë mundësuar me mbështetjen financiare të Komunës së Gjilanit, përmes Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Republika e Kosovës
Komuna Gjilan

INKLUZIONI

ADRESA	Haki Mynderrizi, Nr. 26, 60000 Gjilan, Kosovë
TELEFONI	+383 49 355 400
EMAIL	info@inkluzioni.org
FACEBOOK	facebook.com/p/Inkluzioni-100078710577556/
INSTAGRAM	instagram.com/inkluzioni_/

INKLUZIONI • GJILAN, KOSOVË

Përmbajtja

01. Loja me reagim, radhë dhe komunikim
02. Emërtimi i pjesëve të trupit dhe funksioneve
03. Leximi i librave me figura
04. Fryjmë dhe flasim
05. Përputhja e ngjyrave dhe udhëzimet e thjeshta
06. Zgjidh – Emërto – Vendos
07. Ushtrime para pasqyrës
08. Tregimi, emërtimi dhe përshkrimi i figurave
09. Lidhja e formave dhe ngjyrave
10. Mësimi i përgjigjeve “Po” dhe “Jo”
11. Ngjyrosja e strukturuar
12. Objekti, funksioni dhe kategorizimi
13. Renditja e sekuencave
14. Domino me mjete transporti
15. Shkronja, tingulli dhe kontrolli i lapsit
16. Përputhja e kafshëve me karta vizuale
17. Emëro dhe vepro
18. Loja magnetike me peshq
19. Pllakat me rërë dhe diskriminimi taktil
20. Loja me mozaik
21. Ushtrimet e gjuhës (oromotorike)
22. Vizatimi me gisht në miell
23. Loja me karta figurash
24. Hedhja e topit në shportë
25. Emocionet, ngjyrat dhe format

SI TË PËRDORET KY MATERIAL

Përshtateni çdo aktivitet me moshën, ritmin dhe aftësitë individuale të fëmijës. Modeloni qartë, përsëritni me durim dhe përforconi çdo përpjekje pa presion.

PUNA NË TERREN


Aktivitetet janë realizuar gjatë punës së logopedëve në shtatë institucione edukativo-arsimore në Komunën e Gjilanit, duke përfshirë zonat rurale dhe urbane, si dhe në Qendrën Burimore “Ana”, të themeluar nga Inkluzioni në janar 2026. Në këtë manual ato paraqiten të përmbledhura dhe të organizuara për përdorim praktik.

FOTOGRAFITË DHE VIDEOT

Të gjitha fotografitë dhe videot e përfshira në këtë manual janë reale dhe janë shkëputur nga puna e drejtpërdrejtë me fëmijët në Komunën e Gjilanit, duke përfshirë zonat rurale dhe urbane. Ato paraqesin aktivitetet përkatëse dhe janë përzgjedhur e publikuar duke respektuar privatësinë, dinjitetin dhe identitetin e fëmijëve.

KUJDES

Përshtateni kohëzgjatjen, materialet dhe vështirësinë me moshën dhe aftësitë individuale të fëmijës. Ky material është udhëzues praktik dhe nuk zëvendëson vlerësimin ose planin individual të hartuar nga logopedi.



AKTIVITETI 01

Loja me reagim, radhë dhe komunikim



SHIKO VIDEON

Skano kodin ose kliko figurën

Shiko videon reale të aktivitetit në Facebook

Loja me radhë nxit vëmendjen, reagimin dhe komunikimin funksional.

Ky aktivitet mund të përdoret në fund të seancës logopedike si një lojë argëtuese për fëmijët 5–10 vjeç.

PËRFITIMET E LOJËS:

Mendimi strategjik:

Fëmijët mësojnë të parashikojnë veprimin e partnerit dhe të përqendrohen te udhëzimi verbal. Kur logopedi thotë ngjyrën e gjelbër, fëmija përgatitet dhe përplas pëllëmbën në momentin e duhur.

Studimet tregojnë se lojërat e këtij lloji rrisin funksionet ekzekutive të trurit.

Përqendrimi dhe durimi:

Çdo lëvizje kërkon vëmendje të plotë, duke ushtruar durimin – një aftësi kyçe për suksesin shkollor.

Aftësitë sociale:

Loja me radhë nxit respektimin e partnerit, bashkëpunimin dhe komunikimin verbal me fjali si: “Tani e kam radhën unë”, “Ti ishe më i shpejtë” dhe “Ne fituam”.

“Tani e kam radhën unë”, “Ti e ke bërë më shpejt”, “Ne kemi fituar”.

Menaxhimi i emocioneve:

Fitoret i mësojnë fëmijët të festojnë suksesin, duke ndërtuar vetëbesim dhe qëndrueshmëri emocionale.

Humbjet i ndihmojnë fëmijët ta pranojnë rezultatin dhe ta ruajnë besimin se mund të provojnë përsëri.

AKTIVITETI 02

Emërtimi i pjesëve të trupit dhe funksioneve



Nxitja e të folurit te fëmijët

Përmes këtij aktiviteti, fëmija përfiton në disa drejtime të rëndësishme zhvillimore.


Fëmija mëson të identifikojë dhe të emërtojë pjesët e trupit, si sytë, goja, hunda, veshët dhe duart, si edhe të kuptojë funksionin e tyre: me sy shohim, me gojë flasim dhe hamë, ndërsa me duar prekim dhe mbajmë.


Gjithashtu, aktiviteti ndihmon në rritjen e vetëdijes për higjienën personale, duke e mësuar fëmijën për rëndësinë e larjes së duarve, veçanërisht para ngrënies dhe pas ndotjes së tyre. Kjo kontribuon në krijimin e zakoneve të mira për pastërti dhe kujdes ndaj vetes.

Në të njëjtën kohë, përmes pyetjeve dhe fjalive të thjeshta, fëmija ushtron të folurin, ndërtimin e fjalive dhe përmirëson të kuptuarit verbal, duke lidhur figurën me funksionin dhe me përvojën e përditshme.

AKTIVITETI 03

Leximi i librave me figura




Aktivitet logopedik në shtëpi, i përshtatshëm për fëmijë parashkollorë.

QËLLIMI:


- Zhvillimi i të folurit
- Pasurimi i fjalorit
- Kuptimi i gjuhës
- Nxitja e komunikimit

SI REALIZOHET: Zgjidhni një libër me figura të mëdha. Uluni përballë fëmijës, flisni ngadalë e qartë, tregoni figurën dhe emërtojeni.

SHEMBUJ PRAKTIKË: “Kjo është macja.” “Macja po fle.” “Çfarë po bën macja?” Nëse fëmija nuk flet, modelojeni ju fjalën. Kohëzgjatja e rekomanduar është 5–10 minuta, një ose dy herë në ditë. Përsëritja e të njëjtit libër është më e dobishme se ndërrimi i shpeshtë i librave.

AKTIVITETI 04

Fryjmë dhe flasim



Fryjmë dhe Flasim

> **QËLLIMI**: kontrolli i frymëmarrjes dhe përmirësimi i artikulimit.
>
> **MATERIALET**: pambuk ose topth i lehtë dhe një tavolinë.
>
> **SI BËHET**:

- Fëmija fryn pambukun mbi tavolinë

Pas çdo fryrjeje thotë një tingull ose fjalë:

- ma–me–mi
- pa–po–pu

Përfitime:

- forcon muskujt oralë
- ndihmon në shqiptim të qartë

AKTIVITETI 05

Përputhja e ngjyrave dhe udhëzimet e thjeshta



Aktivitet stimulues për zhvillimin e të folurit.

Nga ky aktivitet fëmija përfiton:

Zgjerimi i fjalorit – fëmija mëson dhe emërton ngjyrat (e kuqe, e gjelbër, e kaltër), duke pasuruar fjalorin.

Të kuptuarit e gjuhës – fëmija ndjek udhëzime të thjeshta, si “Vendose me ngjyrën e njëjtë” dhe “Hidhe topthin këtu”.

Vëmendja dhe përqendrimi – duhet të shikojë kartën, të krahasojë dhe të përputhë ngjyrat, pa u shpërqendruar.

Nxitja e komunikimit – edhe nëse fëmija nuk flet ende, inkurajohet të tregojë me gisht, të zgjedhë, të imitojë ose të provojë të thotë tinguj/fjalë.

Ndërtimi i strukturave të thjeshta gjuhësore – mund të punohet me modele si: “topi i kuq”, “brenda gotës”, “edhe një”, “tjetër”.

Koordinimi sy–dorë, që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e përgjithshëm dhe përgatitjen për të folur.

Aktivitet i thjeshtë në dukje, por shumë funksional për bazat e komunikimit dhe të folurit.

AKTIVITETI 06

Zgjidh – Emërto – Vendos





AKTIVITET LOGOPEDIK: “Zgjidh – Emërto – Vendos”

QËLLIMI:

- Zgjerimi i fjalorit
- Përmirësimi i shqiptimit
- Zhvillimi i kuptimit të udhëzimeve
- Orientimi hapësinor (sipër, poshtë, pranë) Mosha: 2–6 vjeç I përshtatshëm edhe për fëmijë me NVA

MATERIALET: kuba LEGO me ngjyra dhe forma të ndryshme.

- Fëmija zgjedh një LEGO
- E emërton ngjyrën ose formën
- E vendos sipas udhëzimit verbal

SHEMBUJ UDHËZIMESH:

- “Merre LEGO-n e kuqe”
- “Vendose sipër”
- “Cila është e verdha?” Nxisim fëmijën të thotë: “Kjo është e kaltër” “Është e madhe” Këshillë logopedike: Përsëritni fjalët qartë, ngadalë dhe përforconi çdo përpjekje të fëmijës me lavdërim verbal

AKTIVITETI 07

Ushtrime para pasqyrës



USHTRIME PARA PASQYRËS (IMITO)

Udhëzim: Bëji ushtrimet para pasqyrës.

Nxirre gjuhën.

Buzëqesh.


Fryji faqet.

Imito emocionet e paraqitura në fotografi.

Thuaj: sa – se – su. Ky ushtrim ndihmon formimin e tingullit /s/ në kombinim me zanoret.

AKTIVITETI 08

Tregimi, emërtimi dhe përshkrimi i figurave



Ky aktivitet me libra me figura i ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme gjuhësore përmes lojës dhe ndërveprimit.

- Zgjeron fjalorin receptiv dhe ekspresiv
- Nxit emërtimin e objekteve
- Përmirëson të kuptuarit e pyetjeve të thjeshta
- Zhvillon vëmendjen dhe përqendrimin
- Forcon vëmendjen e përbashkët dhe komunikimin funksional
- Ndihmon koordinimin sy–dorë përmes tregimit me gisht

Nxiteni fëmijën të tregojë, të emërtojë dhe të përshkruajë figurat, duke ndërtuar gradualisht fjali të thjeshta.

“Kjo është banane.”

“Banania është e verdhë.”

AKTIVITETI 09

Lidhja e formave dhe ngjyrave




Aktivitet logopedik përmes lojës

Përmes lidhjes së formave dhe ngjyrave, fëmija zhvillon:

- motorikën e imët
- koordinimin sy–dorë
- vëmendjen dhe përqendrimin
- konceptet bazë (forma, ngjyra, renditja)
- gjuhën përmes emërtimit dhe udhëzimeve.

AKTIVITETI 10

Mësimi i përgjigjeve “Po” dhe “Jo”





Përdorimi i përgjigjeve “Po” dhe “Jo” është një aftësi bazë e komunikimit. Ajo mësohet gradualisht dhe në mënyrë të natyrshme përmes situatave të përditshme.


Hapi 1 – Preferencat e fëmijës. Bëni pyetje të thjeshta, si “E do topin?” ose “E do makinën?”, dhe ndihmojeni fëmijën të përgjigjet me fjalë, me lëvizje të kokës ose me gjest.


Hapi 2 – Zgjedhja mes dy objekteve. Ofroni dy lodra dhe pyesni “E do këtë?”, duke e nxitur fëmijën të përgjigjet qartë me “Po” ose “Jo”.

Hapi 3 – Identifikimi i objekteve. Pyesni “A është kjo mollë?” ose “A është kjo makinë?” dhe ndihmojeni fëmijën të dallojë përgjigjen e saktë. Përforcojeni përgjigjen dhe korrigjojeni butë, pa presion.

AKTIVITETI 11

Ngjyrosja e strukturuar





Ngjyrosja e strukturuar është një mënyrë e këndshme për të mësuar përmes lojës dhe një aktivitet mbështetës për stimulimin e të folurit.

- Pasuron fjalorin dhe nxit formimin e fjalive të shkurtra
- Përmirëson artikulimin e tingujve përmes modelimit verbal
- Zhvillon gjuhën receptive (ndjekje udhëzimesh)
- Rrit vëmendjen, përqendrimin dhe qëndrueshmërinë në detyrë
- Forcon motorikën e imët dhe koordinimin sy–dorë
- Nxit vetëbesimin dhe angazhimin aktiv të fëmijës

SI REALIZOHET:

- Vizatimi i thjeshtë i bredhit
- Përdorimi i 2–3 ngjyrave
- Udhëzime verbale të qarta gjatë aktivitetit

SHEMBUJ UDHËZIMESH:

- “Ngjyrose bredhin me të gjelbërt”
- “Ngjyrose topin me ngjyrë të kuqe”
- “Ku është ylli?”

FOKUS NË TINGUJ:

- Sh – shirit, shkop
- S – sferë
- T – top

AKTIVITETI 12

Objekti, funksioni dhe kategorizimi



Ky aktivitet ndërthur të folurin, të menduarit dhe vëmendjen. Fëmija zgjeron fjalorin, lidh objektin me funksionin e tij, kupton pyetje të thjeshta, ndërton fjali të shkurtra, përmirëson shqiptimin dhe ushtron kategorizimin e ushqimeve, mjeteve dhe kafshëve.

AKTIVITETI 13

Renditja e sekuencave





Sekuencat janë renditje hap pas hapi të një veprimi ose ngjarjeje. Fëmija kupton çfarë ndodh fillimisht, çfarë vjen më pas dhe si përfundon ngjarja. Aktiviteti forcon rendin logjik, të folurin, vëmendjen dhe durimin.

- fjali
- tregim) rrisin vemendjen dhe durimin e ndihmojne femijen me tregu çka po ndodh pa u hutuar

SI REALIZOHET: Vendosini figurat të përziera dhe kërkojini fëmijës t'i rendisë. Pyesni "Çfarë vjen e para?" dhe "Çfarë ndodh pastaj?". Filloni me fjali të shkurtra; nëse ka vështirësi, modelojeni fjalinë dhe kërkojini ta përsërisë.

AKTIVITETI 14

Domino me mjete transporti



Domino e mjeteve të transportit

Kjo lojë e tipit domino është e thjeshtë, e përsëritshme, shumëgjuhësore dhe argëtuese. Fëmijët e pëlqejnë shumë dhe dëshirojnë ta luajnë në çdo seancë.

Si zhvillohet loja?

Fillimisht, fëmijës i ofrohen kartat me figura të mjeteve të transportit me qëllim që t'i identifikojë dhe t'i përputhë sipas figurave të njëjta. Aktiviteti realizohet fillimisht përmes modelimit nga logopedi dhe më pas me përfshirjen e fëmijës në mënyrë të pavarur.

SHEMBUJ UDHËZIMESH PËR FËMIJËN:

Gjeje autobusin.

Sa autobusë i ke gjetur? (numërimi)

Çfarë ngjyre ka autobusi?

Sa dritare i ka?

Përfitimet e lojës

- Zhvillimi i të folurit dhe zgjerimi i fjalorit

Emërtimi i saktë i mjeteve të transportit: aeroplan, autobus, veturë, anije, tren, traktor, helikopter, kamion, biçikletë.

Përdorimi i fjalëve në numrin njëjës dhe shumës:

një autobus – shumë autobusë.

- Formimi i fjalive të thjeshta dhe të zgjeruara

Këtu është autobusi.

Autobusi është me ngjyrë të verdhë dhe ka shumë dritare.

Unë e bashkoj autobusin me autobusin tjetër sepse janë të njëjtë.

- Përforcimi i artikulimit të tingujve

Përforcimi i tingujve (a, b, k, t, h, v) përmes përsëritjes së emrave të mjeteve të transportit.

- Zhvillimi i të menduarit logjik dhe aftësive vizuale

Njohja dhe krahasimi i figurave identike (përputhshmëria vizuale).

Kuptimi i rregullit të lojës domino: figurat duhet të jenë saktësisht të njëjta për të vazhduar lojën.

- Zhvillimi i komunikimit verbal dhe joverbal

Fëmija mëson të tregojë figurën me gisht dhe ta emërtojë njëkohësisht (“Këtë dua”).

Para vendosjes së dominës, fëmija mëson të shikojë në sy terapistin ose prindin dhe të thotë:

“Shiko, aeroplani!”


Përdorimi i gjesteve funksionale që shoqërojnë fjalinë:

Kur thotë: Aeroplani fluturon në qiell, ngre duart lart si krahë.

Kur thotë: Vetura bën bip-bip, imiton shtypjen e timonit.

AKTIVITETI 15

Shkronja, tingulli dhe kontrolli i lapsit



Përfitimet logopedike të këtij ushtrimi:

Zhvillon motorikën e imët dhe kontrollin e lapsit.

Ndihmon në formimin e saktë të shkronjës

Forcon lidhjen tingull–shkronjë

Përmirëson shqiptimin e tingullit

Rrit vëmendjen, përqendrimin dhe qëndrimin në detyrë.

AKTIVITETI 16

Përputhja e kafshëve me karta vizuale



Në këtë aktivitet fëmija përdor karta vizuale dhe figura plastike të kafshëve. Ai identifikon kartën dhe e përputh me figurën përkatëse.

Përfitimet gjuhësore të aktivitetit:

Zhvillimi i fjalorit receptiv dhe ekspresiv

Përmirësimi i të kuptuarit të udhëzimeve

Zhvillimi i kategorizimit dhe lidhjes vizuale

Nxitja e të folurit funksional

Zhvillimi i vëmendjes dhe qëndrimit në detyrë

Nxitja e lojës simbolike

AKTIVITETI 17

Emëro dhe vepro









Aktivitet: “Emëro dhe vepro”

QËLLIMI: stimulimi i gjuhës përmes lëvizjes dhe imitimit. Prindi jep një udhëzim të shkurtër; fëmija e kryen veprimin dhe e përsërit me zë. Shembuj: “Kërce tri herë”, “Trokit duart dhe thuaj bravo”, “Prek hundën dhe thuaj: hunda ime”, “Ulu, ngrihu dhe thuaj: unë mundem”.


RREGULLI I LOJËS: fëmija kryen veprimin dhe e shpreh me fjali. Shembull: prindi thotë “Trokit duart dhe thuaj bravo”; fëmija troket duart dhe thotë “Bravo!”.

Pse është i vlefshëm?

- Stimulon fjalorin dhe ndërtimin e fjalisë.
- Përmirëson kuptimin e udhëzimeve.
- Rrit vëmendjen dhe përqendrimin.
- Aktivizon trupin dhe gjuhën në të njëjtën kohë.

AKTIVITETI 18


Loja magnetike me peshq



Loja magnetike me peshq zhvillon koordinimin sy–dorë, lëvizjet e sakta të gishtërinjve, vëmendjen dhe pritjen e radhës. Fëmija emërton peshqit dhe ngjyrat, mëson koncepte si brenda–jashtë, lart–poshtë dhe i madh–i vogël, si edhe ndjek udhëzime me një ose dy hapa. Gjatë lojës nxiten fjali të thjeshta, si “Po e kap peshkun” dhe “Peshku është në det”.

AKTIVITETI 19

Pllakat me rërë dhe diskriminimi taktil



Pllakat me rërë, të renditura nga më e trasha te më e holla, ndihmojnë stimulimin ndijor dhe përpunimin shqisork, veçanërisht te fëmijët që kanë nevojë të forcojnë shqisën e prekjes.

PËRFITIMET KRYESORE:

- Zhvillon ndjeshmërinë e prekjes: Fëmija dallon sipërfaqet e ashpra dhe të buta.
- Rrit diskriminimin taktil: Dallon trashësinë vetëm me prekje, pa e parë.
- Forcon përqendrimin: Përqendrohet te ndjesia dhe detyra që po kryen.
- Ndihmon rregullimin shqisoral: Mund të jetë qetësuese ose stimulese, sipas nevojës.
- Zhvillon koordinimin dorë–sy: Sidomos kur renditen pllakat nga më e trashë te më e holla.
- Përgatit dorën për shkrim: Aktivizon receptorët e gishtave të rëndësishëm për kontrollin e shkrimit.

AKTIVITETI 20

Loja me mozaik







Loja me mozaik zhvillon gjuhën dhe fjalorin, rrit vëmendjen, forcon të menduarit logjik dhe nxit përdorimin e fjalive të shkurtra. Ajo përmirëson koordinimin sy–dorë, vetëbesimin dhe komunikimin social përmes bashkëpunimit, respektimit të rregullave dhe pritjes së radhës.

AKTIVITETI 21

Ushtrimet e gjuhës (oromotorike)




Ushtrimet bukofaciale (oromotorike) mbështesin zhvillimin e forcës, koordinimit dhe lëvizshmërisë së gjuhës dhe buzëve, aftësi të rëndësishme për shqiptimin e qartë të tingujve.

- Përmirësim të kontrollit të gjuhës
- Rritje të tonusit dhe forcës së muskujve
- Lëvizshmëri më të mirë (sipër/poshtë, majtas/djathtas)
- Përgatitje për tinguj të vështirë si: L, Rr, S, Sh, Zh
- Ndërgjegjësim për pozicionin e gojës gjatë të folurit Si realizohet aktiviteti?
- Zgjedhim kartelën me pozicionin e gjuhës
- Logopedi modelon lëvizjen
- Fëmija e imiton
- Pozicioni mbahet 2–5 sekonda
- Përsëritet disa herë për të forcuar kontrollin Ky është një aktivitet i thjeshtë, por shumë efektiv në ndërtimin e bazës motorike orale për shqiptim të qartë dhe të saktë.

AKTIVITETI 22

Vizatimi me gisht në miell



Në këtë aktivitet fëmija formon figura duke vizatuar me gisht në një enë me miell. Kjo mënyrë ndijore e të mësuarit zhvillon motorikën e imët, kujtesën vizuale dhe koordinimin sy–dorë.

Përfitimet gjuhësore:

Ndihmon në njohjen dhe formimin e figurave në mënyrë të natyrshme.

Zhvillon përqendrimin dhe vëmendjen gjatë procesit të të mësuarit.

Nxit të folurin përmes përshkrimit të veprimeve: “Po bëj një fytyrë të lumtur” dhe “Kjo duket si një rreth”.

Kjo është një ide e thjeshtë që prindërit mund ta realizojnë lehtësisht edhe në shtëpi, duke e kthyer momentin e lojës në një aktivitet të vlefshëm gjuhësor.

AKTIVITETI 23

Loja me karta figurash





Përmes lojës me karta figurash, fëmijët zhvillojnë aftësitë gjuhësore, pasurojnë fjalorin dhe lidhin fjalët me kuptime konkrete. Pyetjet, përgjigjet dhe bisedat e shkurtra i ndihmojnë ta kuptojnë më mirë botën përreth.

- Dy zemra të vogla që mësojnë bashkë, duke u rritur me fjalë, dashuri dhe kujdes çdo ditë.

AKTIVITETI 24

Hedhja e topit në shportë



Ilustrim orientues i Aktivitetit 24.

Udhëzime për prindërit: aktivitet motorik për zhvillimin e koordinimit sy–dorë dhe kontrollit të lëvizjeve përmes hedhjes së topit në shportë.

SI REALIZOHET:

Fëmija hedh një top të butë drejt një shporte ose kutie. Distanca përshtatet me moshën dhe aftësitë e fëmijës, duke filluar nga rreth 50 centimetra.

NDIKIMI:

Ky ushtrim ndihmon fëmijën të:

- zhvillojë koordinimin sy–dorë dhe vëmendjen vizuale,
- forcojë muskujt e dorës dhe gishtave,
- ushtrojë kontrollin e lëvizjeve të imta – aftësi të rëndësishme për shkrim, prerje dhe vetëkujdes,
- mësojë përmes lojës dhe komunikimit,
- dallojë ngjyrat dhe format, duke rritur përqendrimin dhe durimin.

Një aktivitet i thjeshtë me shumë vlera zhvillimore.

AKTIVITETI 25

Emocionet, ngjyrat dhe format



- Përgatitni karta me fytyra dhe emocione, karta me fruta, ngjyra ose forma, si dhe një fletë pune me vija për gjurmim.
- Vendosni kartat para fëmijës dhe kërkojini të zgjedhë, të emërtojë dhe të përshkruajë emocionin, ngjyrën, frutin ose formën që sheh. Jepni model verbal kur fëmija ka nevojë për ndihmë.
- Më pas, ftojeni fëmijën të ndjekë vijat me laps ose marker dhe të grupojë kartat sipas ngjyrës, formës apo emocionit. Përsëritni fjalët qartë dhe përforconi çdo përpjekje me lavdërim.